

**VENDIM**  
**Nr.128, datë 11.3.2004**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.459, DATË 23.9.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET"**

Në mbështetje të neneve 10 e 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin e funksionimit të Këshillit të Ministrave" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet për të ndihmuar në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, që kanë objekt dhe ndjekin qëllime besimi dhe ndërgjegjje, sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë.

Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, person juridik në varësi të Kryeministrit."

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Gjatë emërimit të përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, Kryeministri dhe kryetari i tij marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjansisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin që struktura e komitetit të reflektojë, realisht, identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave."

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Pagat e nëpunësve të Komitetit Shtetëror për Kultet të jenë sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndërsa punonjësit e tjerë të paguheshin sipas lidhjes II-5 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

Lidhja nr.1

| Emërtimit  | Paga mujore                     |                                      |                                |                              |
|------------|---------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------|------------------------------|
|            | Paga individuale<br>(Paga bazë) |                                      |                                | Shtesa e<br>pozicionit       |
|            | 1                               | 2                                    | 3                              | 4                            |
|            | Paga e grupit<br>(PG)           | Shtesa vjetore për<br>vjetërsi (SHV) | Shtesa për<br>kualifikim (SHK) | Shtesa për<br>pozicion (SHP) |
| Kryetar    | 9 000                           | 2%                                   | 0                              | 90 000                       |
| Anëtar     | 9 000                           | 2%                                   | 0                              | 55 000                       |
| Specialist | 9 000                           | 2%                                   | 0                              | 20 000                       |